



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2019

PËR

PRODHIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN
E BIOKARBURANTEVE DHE TË LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE,
TË RINOVUESHME, PËR TRANSPORT¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj synon promovimin e prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në sektorin e transportit në Shqipëri, për të kontribuar në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në kontributin kombëtar të synuar për reduktim të gazeve me efekt serrë, si dhe për të kontribuar në përmbushjen e objektivave lidhur me përdorimin e burimeve të rinovueshme të përcaktuara në kuadër të Komunitetit të Energjisë. Ky ligj ka si qëllim përdorimin e burimeve energjetike të rinovueshme, nëpërmjet nxitjes e kultivimit të bimëve energjetike, për të mbrojtur mjedisin nëpërmjet respektimit të kriterëve të qëndrueshmërisë për biokarburantet dhe biolëngjet, si dhe plotësimin e kërkesave për cilësinë e karburanteve në transport.

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën 2009/28/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 prill 2009, “Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e energjive të rinovueshme”, e cila shfuqizon direktivën 2001/77/KE dhe direktivën 2003/30/KE

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet në veprimtaritë e prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, të cilat në formë të pastër ose të përzier, në përqindje të caktuar me nënprodukte të tjera të rafinimit të naftës bruto, përdoren në sektorin e transportit për motorë me djegie të brendshme.
2. Ky ligj zbatohet në veprimtarinë e përdorimit të biokarburanteve në sektorin e transportit kombëtar, kur nivelet e biodiezelit dhe bioetanolit janë në përputhje me standardet shqiptare.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. **“Biomasa”**, pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbetjeve të shpërbëshme organike, që përftohen si lëndë e parë nga veprimtaria bujqësore, e pyjeve, peshkimit dhe veprimtarive të lidhura me to, duke përfshirë lëndët bimore, drusore e shtazore, dhe materiale të ngjashme industriale, si dhe pjesa e mbetjeve të shpërbëshme organike industriale dhe e mbetjeve të shpërbëshme organike, rurale dhe urbane.
2. **“Biokarburante”**, lëndë djegëse për sektorin e transportit, në trajtë të lëngët ose të gaztë, të cilat prodhohen nga biomasa dhe veçanërisht:
 - a) **“Biodiezel”** (diesel me prejardhje organike), metil-esteri yndyror dhe etil-esteri i acideve yndyrore metilike, që prodhohen nga vajra bimore (biomasa) ose shtazore dhe nga dhjamra e mbetje të vajrave dhe dhjamra prej kafshëve apo vegjetale dhe fraksionet e tyre të përdorura.
 - b) **“Bioetanol”**, etanoli që prodhohet nga biomasa ose nga fraksionimi i mbetjeve të shpërbëshme organike.
 - c) **“Biogaz”**, lëndë djegëse e gaztë, që prodhohet nga biomasa ose fraksionimi i mbetjeve të shpërbëshme organike, industriale dhe urbane, të cilat mund të pastrohen e të përmirësohen, në cilësinë e gazit natyror, për t’u përdorur si biokarburant ose gaz druri.
 - ç) **“Biometanol”**, metanoli që prodhohet nga biomasa, për t’u përdorur si biokarburant.
 - d) **“Biodimetileter”**, dimetileteri që prodhohet nga biomasa, për t’u përdorur si biokarburant.
 - dh) **“Bio-ETBE”** është Etil-Tercio-Butil-Eter, që prodhohet nga bioetanolit, për t’u përdorur si biokarburant. Përqindja, sipas vëllimit të Bio-ETBE-it,

që përllogaritet si biokarburant në formën e pastër, është 47 për qind e totalit të tij.

- e) **“Bio-MTBE”**, Metil-Tercio-Butil-Eter që prodhohet nga biometanoli, për t’u përdorur si biokarburant në formën e pastër. Përqindja, sipas vëllimit të Bio-MTBE-it, që përllogaritet si biokarburant, është 36 për qind e totalit të tij.
 - ë) **“Biokarburant sintetik”**, hidrokarburet sintetike ose përzierja (mishela) e hidrokarbureve sintetike, që prodhohen nga biomasa.
 - f) **“Biohidrogjen”**, hidrogjeni që prodhohet nga biomasa dhe/ose nga fraksionimi i shpërbërjes së mbetjeve organike, industriale dhe urbane, për t’u përdorur si biokarburant.
 - g) **“Vajra bimore të pastra”**, vajrat që përdoren si lëndë e parë dhe që prodhohen nga bimë vajore energjetike, me shtypje, shtrydhje ose metoda të tjera, në gjendje natyrore ose të përmirësuar, por të pandryshuara kimikisht, kur përshtaten me tipin e motorit ose të pajisjes së përdorur dhe me kërkesat përkatëse të emetimeve të ndotjeve të gazit.
 - gj) **“Biodiezel i përzier”**, një karburant i përbërë nga biodiezel i pastër me diezel të prodhuar nga përpunimi i naftës bruto, në raport të caktuar, me qëllim përmbushjen e specifikimeve të standardit SH EN 590 në fuqi.
 - h) **“Biobenzinë e përzier”**, një karburant i përbërë nga biometanol ose bioetanol të pastër me benzinë, e prodhuar nga përpunimi i naftës bruto, në raport të caktuar, me qëllim përmbushjen e specifikimeve të standardit SSH EN 228 në fuqi.
3. **“Biolëngjet”**, lëndë djegëse të lëngëta, të prodhuara nga biomasa për përdorim për qëllime energjetike, pa përfshirë sektorin e transportit, duke përfshirë energjinë elektrike, ngrohjen dhe ftohjen.
 4. **“Lëndë të tjera djegëse të rinovueshme”**, lëndët djegëse të rinovueshme, përveç biokarburanteve, që kanë prejardhje nga burime jofosile të energjisë së rinovueshme, të cilat përdoren për qëllime transporti, sikurse janë energjia e biomasës, e gazit të landfillit, e gazit të impianteve të trajtimit të ujërave urbane dhe të biogazit.
 5. **“Prodhimi i biokarburanteve”**, përpunimi i lëndëve të para të përshtatshme në impiante të posaçme, të prodhimit të biokarburanteve sipas përcaktimeve të mësipërme ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.
 6. **“Përzierja e biokarburanteve”**, procesi i përzierjes së biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të përftuara nga distilimi i naftës bruto.
 7. **“Njësi të prodhimit të biokarburanteve”**, personat juridikë, të cilët zotërojnë impiante për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.
 8. **“Impiante për prodhimin e biokarburanteve”**, janë impiantet e posaçme, të zotëruara nga njësitë e prodhimit të biokarburanteve, në të cilat realizohet

prodhimi i biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përfshirë edhe mjediset e nevojshme të magazinimit.

9. **“Njësi të përzierjes së biokarburanteve”**, personat juridikë, të cilët zotërojnë impiante për përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.
10. **“Impiantet për përzierjen e biokarburanteve”**, instalime të posaçme, me mjedise të nevojshme magazinimi, ku realizohet përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto.
11. **“Kultivim energjetik”**, prodhimi dhe tregtimi i atyre bimëve, për prodhimin e produkteve, që vlerësohen si lëndë e parë djegëse, me bazë organike të rinovueshme.
12. **“Përmbajtja energjetike”**, fuqia minimale kalorifike (termogjene) e një lënde djegëse.
13. **“Rafineri”**, instalime komplekse teknologjike, përfshirë edhe kapacitetet depozituese të lëndës së parë, të gjysmëprodukteve dhe produkteve të gatshme, ku kryhet përpunimi i naftës bruto apo i nënprodukteve të saj, për përfitim të nënprodukteve apo produkteve të gatshme.
14. **“Shoqëri tregtimi me shumicë”**, personi juridik që blen naftë bruto dhe nënproduktet e saj, përfshirë biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, me qëllim shitjeje të konsumatorët e mëdhenj ose të tretët për rishitje.
15. **“Shoqëri tregtimi me pakicë”**, personi juridik që blen nënprodukte të naftës bruto, përfshirë biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, me qëllim shitjeje të personat që janë konsumatorë fundorë.
16. **“Konsumatorë të mëdhenj”**, personat juridikë që konsumojnë për nevojat e veta nënproduktet e naftës bruto, përfshirë biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, në një sasi jo më pak se 50 m³ në muaj dhe që posedojnë instalime depozitimi të këtyre produkteve.
17. Termat **“Standard”**, **“Standard shqiptar”** dhe **“Rregulla teknike”**, të përcaktuar në këtë ligj, kanë kuptim në përputhje me përdorimin e tyre në ligjin nr.9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar.

Neni 4

Objektivat kombëtarë

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarive të prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, synohet të arrihen këto objektiva:
 - a) Sasia minimale vjetore në treg e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, duhet të jetë jo më pak se 5 për qind e sasisë së konsumuar në sektorin e transportit në vitet 2018 dhe 2019. Nga viti 2020 e në vazhdim, kjo sasi do të jetë jo më pak se 10%;

- b) Nxitja e prodhimit dhe e përdorimit të biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që plotësojnë kriteret e qëndrueshmërisë në përputhje me nenin 9, të këtij ligji, në sektorin e transportit kombëtar, nëpërmjet vendosjes së objektivave tregues kombëtarë, të shprehur në përqindje për praninë në treg të këtyre produkteve;
 - c) Garantimi i efektshmërisë optimale të punës së motorit, duke respektuar normat e cilësisë dhe ato teknike në prodhimin e përdorimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme. Ministria përgjegjëse për transportin rrugor, nëpërmjet distributorëve ligjorë të mjeteve dhe klubit të automobilizmit në Republikën e Shqipërisë, publikon të dhëna mbi efektshmërinë e motorëve ekzistues, në përputhje me cilësinë e karburanteve të përdorura;
 - ç) Dhënia e kontributit në mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit;
 - d) Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorëve të bujqësisë dhe pyjeve si stimul për zhvillimin rural dhe nxitje të punësimit, duke respektuar kriterin e qëndrueshmërisë;
 - dh) Ulja e sasisë së emetimeve të ndotësve në ajër dhe të emetimeve të gazeve me efekt serrë, të çliruara në mjedis nga veprimtaritë në sektorin e transportit.
2. Mbi bazën e objektivave kombëtarë vjetorë të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, dhe në përputhje me parashikimet e nenit 12, të këtij ligji, ministri përgjegjës për hidrokarburet përcakton me urdhër sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që do të përdoren gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit, si dhe sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që do të hidhen në treg gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit nga çdo shoqëri e tregtimit me shumicë.
 3. Objektivi i sasisë minimale vjetore të biokarburanteve, të prodhuara nga mbetje, materiale celulozike joushqimore dhe materialet linjo-celulozike, që rezultojnë nga mbetjet, është sa gjysma e nivelit të objektivit të përcaktuar për biokarburantet e tjera.

Neni 5

Licencimi

1. Veprimtaria e tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierjeje, realizohet nga subjektet e parashikuara në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe në këtë ligj, të cilat janë licencuar sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Veprimtaria e tregtimit me shumicë e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierjeje, përfshihet në licencën “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A” dhe licencohet sipas ligjit për licencat.

Licencimi për veprimtarinë e tregtimit me pakicë e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierjeje bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

2. Licenca e prodhimit dhe e përzierjes së biokarburanteve, përfshirë pezullimin dhe revokimin, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë VIII.1, të shtojcës së ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe jepet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, në përputhje me nenin 13, të këtij ligji.
3. Biokarburantet e lëngshme ose të gazta dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, të pastra ose të përziera, të cilat zëvendësojnë produkte të naftës, quhen gjithashtu nënprodukte të naftës, në kuptim të dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, duke iu referuar kategorive respektive të nënprodukteve të naftës që ato zëvendësojnë, sipas grupit të përcaktuar në këtë ligj, për këto kategori.

KREU II

ORGANIZIMI I VEPRIMTARIVE TË PRODHIMIT DHE TË TREGTIMIT TË BIOKARBURANTEVE DHE TË LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE, TË RINOVUESHME

Neni 6

Implantet për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport

1. Personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitetin në fushën e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme dhe përzierjes së tyre me nënproduktet e naftës, për transport, në impiante për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, duhet të jenë të krijuar në formën e shoqërive aksionare.
2. Ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të prodhimit të biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, bëhen pasi njësitë që i zotërojnë ato të jenë pajisura, sipas dispozitave të këtij ligji, me licencë prodhimi. Personat juridikë të pajisur me licencë prodhimi kanë të drejtë të bëjnë edhe procesin e përzierjes së biokarburanteve me nënproduktet e naftës.

3. Shfrytëzimi i impiantit të prodhimit të biokarburanteve, të zotëruara nga njësitë e prodhimit, të biokarburanteve, fillon pas vërtetimit të dhënë nga inspektorati shtetëror përgjegjës, që vëren se janë plotësuar kushtet teknike, të cilat duhet të respektohen gjatë të gjithë afatit të përcaktuar në licencën e prodhimit.
4. Njësitë e prodhimit të biokarburanteve kanë të drejtë të tregtojnë prodhimet e tyre te rafineritë e naftës, njësitë e përzierjes së biokarburanteve, shoqëritë e tregtimit me shumicë të pajisura me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A” të shoqëritë e tregtimit me pakicë, të konsumatorët e mëdhenj dhe t’i eksportojnë ato.
5. Njësitë e prodhimit dhe të përzierjes së biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përgjigjen për markën e prodhimit dhe cilësinë e produkteve që prodhojnë ose përziejnë, në përputhje me standardet në fuqi. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për hidrokarburet, vendos për standardin që do të respektohet brenda 6 (gjashtë) muajve nga miratimi i këtij ligji.
6. Njësitë për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, janë të detyruara të paraqesin në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet të dhëna për programin e zhvillimit, si dhe të dhëna periodike për sasinë dhe cilësinë e hedhur në tregun e brendshëm.
7. Lloji i të dhënave, forma dhe afatet e dërgimit të tyre nga njësitë për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përcaktohen me urdhër nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.
Ministria përgjegjëse për hidrokarburet publikon në faqen zyrtare të dhëna që promovojnë përdorimin e biokarburanteve dhe përgjigjet për përditësimin e këtyre të dhënave.

Neni 7

Përgatitja për tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, ruhen, magazinohen, transportohen dhe tregtohen vetëm kur përmbushin standardet, në përputhje me pikën 5, të nenit 6, dhe përcaktimet e shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 4, të këtij ligji.

2. Ruajtja, magazinimi dhe transportimi i biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, realizohen në depozita ose impiante magazinimi dhe transportimi të përshtatshme për këto lloj produktesh, të cilat plotësojnë kushtet e parametrat teknike dhe të sigurisë, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto realizohet vetëm në instalimet e posaçme dhe në përgjegjësinë e personave juridikë të pajisur me “licencë prodhimi” ose “licencë për përzierje”, si dhe nga rafineritë e naftës të pajisura me licencë koncesioni, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Impiantet e prodhimit, të cilat tregtojnë biokarburante dhe lëndë të tjera djegëse, të rinovueshme, duhet të disponojnë instalime për depozitimin e tyre dhe për realizimin e përzierjes së biokarburanteve me nënprodukte të naftës bruto. Këto shoqëri përgjigjen për funksionimin e këtyre instalimeve, në përputhje me normat teknike të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe me masat e mbrojtjes nga zjarri (MMZ).
5. Impiantet që kryejnë vetëm procesin e përzierjes së biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto duhet të pajisen me “Licencë për përzierje” nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Procedurat dhe kushtet për dhënien e “Licencës së përzierjes” miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.
6. Impiantet ku realizohet përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto, duhet të jenë të licencuara si magazina fiskale, doganore ose të lira, të pajisura me autorizim sipas përcaktimeve të ligjit nr.61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
7. Inspektorati shtetëror përgjegjës organizon dhe ushtron kontroll ndaj personave juridikë që i nënshtrohen këtij ligji, lidhur me respektimin e dispozitave ligjore sipas këtij ligji, për kontrollin e treguesve cilësorë, si dhe të normave të tjera ligjore e nënligjore, për parandalimin e abuzimeve e të falsifikimeve që nga çasti i hyrjes së mallit në pikat doganore deri në procesin përfundimtar të shitjes së tyre.

Neni 8

Organizimi i tregut të biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Veprimtaritë e importimit, të eksportimit dhe të tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierJE me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, realizohen nga impiantet e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, nga shoqëritë e pajisura me “Licencë” “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A” dhe nga rafineritë e naftës të pajisura me licencë koncensionit, sipas dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.
Shoqëritë e pajisura me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A” kanë të drejtë të realizojnë përzierje, pasi të jenë pajisur me “Licencë për përzierje”.

- Shoqëritë e pajisura me licencën “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A”, kanë të drejtë të ushtrojnë vetëm aktivitetin e tregtimit me shumicë të biokarburanteve të lëngshme ose të gazta dhe/ose lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, të pastra ose të përziera.

2. Shoqëritë e tregtimit me pakicë të nënprodukteve të naftës, të pajisura me licencë, sipas dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, kanë të drejtë të shesin me pakicë biokarburante, në formë të pastër ose të përzier me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, duke zbatuar standardet shqiptare.

3. Në dokumentacionin përkatës doganor dhe administrativ shoqërues të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose të përzier me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, duhet të përcaktohen në mënyrë të detyrueshme, të dhëna për përqindjen e biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që përzihen me nënproduktin respektiv të naftës bruto.

4. Shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, të cilat tregtojnë edhe biokarburante, janë të detyruara që në instalimet e tregtimit ose në pikat e shitjes së tyre të afishojnë në reklamat dhe pompat e karburantit, në mënyrë të dukshme dhe të qartë, një shënim të posaçëm për:

- a) biokarburantet ose lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, që tregtojnë;
- b) diezelin e përzier me biodiezel, për lëvizje automjetesh, në rastet kur përqindja e lëndës bio është mbi nivelin e përqindjes së përcaktuar nga standardet në fuqi;
- c) benzinën e përzier me bioetanol, për lëvizje automjetesh, në rastet kur përqindja e lëndës bio është mbi nivelin e përqindjes së përcaktuar nga standardet në fuqi.

Karakteristikat e shënimit të posaçëm përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

5. Veprimtaria e transportimit dhe tregtimit të lëndëve djegëse për transport, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe biokarburante, bëhet sipas dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

Neni 9

Kriteret e qëndrueshmërisë së biokarburanteve

1. Energjia e prodhuar nga biokarburantet apo biolëngjet, pavarësisht nëse lëndët e para që kanë shërbyer për prodhimin e biokarburanteve janë kultivuar brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë, merret në konsideratë sipas qëllimeve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, vetëm nëse përmbushen kriteret e qëndrueshmërisë, të përcaktuara në këtë nen.
2. Energjia e prodhuar nga biokarburantet apo biolëngjet merret në konsideratë për qëllimet, si më poshtë vijon:
 - a) Për përmbushjen e objektivave kombëtarë të burimeve të rinovueshme të energjisë në sektorin e transportit;
 - b) Për pajtueshmërinë me detyrimet e vendosura nga legjislacioni dhe Plani Kombëtar për Burimet e Rinovueshme të Energjisë.

Biokarburantet dhe biolëngjet e prodhuara nga mbetje të tjera nga mbetjet bujqësore, akuakulturore, nga peshkimi dhe nga mbetjet e pyjeve, duhet të përmbushin vetëm kriteret e qëndrueshmërisë të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, për qëllimet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike.

3. Reduktimi i emetimeve të gazeve serrë, nëpërmjet përdorimit të biokarburanteve dhe biolëngjeve, duhet të jetë të paktën 35%.

Rregullat për llogaritjen e ndikimit në uljen e sasisë së gazeve me efekt serrë nga prodhimi e përdorimi i biokarburanteve dhe biolëngjeve përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

4. Biokarburantet dhe biolëngjet nuk duhet të jenë të prodhuara nga lëndë të para të përftuara nga zona me vlera të larta biodiversiteti, si më poshtë vijon:
- a) Pyje dhe terrene pyjore ku nuk ushtrohen aktivitete të njeriut dhe ku proceset ekologjike nuk janë modifikuar në mënyrë të dukshme;
 - b) Zona të kategorizuara, si më poshtë vijon:
 - i. Zona të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi; ose
 - ii. Zona, për të cilat është vendosur mbrojtja e ekosistemeve apo specieve të rralla, të kërcënuara ose të vëna në rrezik zhdukjeje.
 - c) Kullota natyrore me vlerë të lartë biodiversiteti, të kategorizuara, si më poshtë vijon:
 - i. Kullota, të cilat do të mbeten të njëjta nëse nuk do ketë ndërhyrje njerëzore dhe që ruajnë përbërjet e specieve natyrore, si dhe karakteristikat dhe proceset ekologjike;
 - ii. Kullota jonatyrore, që nuk do të ishin të tilla në mungesë të ndërhyrjes njerëzore dhe që janë të pasura dhe jo të degraduara, përveç faktit nëse nuk dëshmohet që korrja e lëndëve të para është e nevojshme për të ruajtur statusin e saj si kullotë.
5. Biokarburantet dhe biolëngjet nuk duhet të jenë të prodhuara nga lëndë të para të përftuara nga toka, të cilat kanë një përqendrim të madh karboni, të kategorizuara, si më poshtë:
- a) Zona me lagështirë ose terrene të mbuluara ose të ngopura me ujë, në mënyrë të përhershme ose për pjesën më të madhe të vitit;
 - b) Zonat pyjore të shtrira në më shumë se një hektar dhe të karakterizuara nga pemë të gjata mbi 5 metra dhe nga një mbulim i sipërfaqes mbi 30%;
 - c) Toka që kanë një zgjerim në më shumë se një hektar dhe të karakterizuara nga prania e pemëve me një lartësi mbi 5 metra dhe një mbulim të sipërfaqes përfshirë midis 10% dhe 30%.
6. Biokarburantet dhe biolëngjet nuk duhet të jenë të prodhuara nga lëndë të para të përftuara nga një tokë që është moçal, përveç kur jepen fakte që kultivimi dhe mbjellja e këtyre lëndëve të para nuk përbën kullim të tokës, e cila nuk ishte kulluar më parë.

Neni 10

Verifikimi i kriterëve të qëndrueshmërisë së biokarburanteve

1. Në rastin kur biokarburantet dhe biolëngjet merren në konsideratë për qëllimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 9, të këtij ligji, struktura përgjegjëse për verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë, verifikon nëse operatorët ekonomikë kanë respektuar kriteret e qëndrueshmërisë të përcaktuara në nenin 9, të këtij ligji. Në këtë rast, operatorët ekonomikë janë të detyruar:
 - a) të lejojnë që sasi të lëndëve të para ose biokarburante me karakteristika të ndryshme qëndrueshmërie të përzihen;
 - b) të informojnë mbi karakteristikat e qëndrueshmërisë dhe mbi volumet e përzierjeve të përmendura në shkronjën “a”, të kësaj pike, dhe t'i mbajnë ato të pandryshuara;
 - c) të sigurojnë që përzierja të ketë të njëjtat karakteristika të qëndrueshmërisë, me sasi të lëndëve që i janë shtuar përzierjes.
2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për hidrokarburet, miraton vendimin për përcaktimin e strukturës përgjegjëse dhe metodologjinë për verifikimin e plotësimit të kriterëve të qëndrueshmërisë, të parashikuara në nenin 9, të këtij ligji.
3. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet i raporton Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për masat kombëtare të marra për respektimin e kriterëve të qëndrueshmërisë, të përcaktuara në nenin 9, të këtij ligji.

Neni 11

Afati i zbatimit të kriterëve të qëndrueshmërisë së biokarburanteve

Zbatimi i kriterëve të qëndrueshmërisë, të parashikuara në nenin 9, të këtij ligji, do të fillojë nga data 1 janar 2020 e në vazhdim.

Neni 12

Përlllogaritja e sasisë vjetore minimale të konsumit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Sasia minimale vjetore e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, e rinovueshme, që do të përdoret gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit, përcaktohet në raport me sasinë vjetore të benzinës dhe të diezelit të vendosur në treg për transport nga çdo shoqëri tregtimi me shumicë. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për hidrokarburet, miraton udhëzimin për mënyrën e përcaktimit të sasisë minimale vjetore të

biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, të vendosura në treg.

2. Ministri përgjegjës për hidrokarburet, mbështetur në udhëzimin e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, përcakton sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që do të përdoren gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit, përfshirë edhe sasinë minimale të biokarburanteve që do të hidhet në treg nga çdo shoqëri e tregtimit me shumicë.
3. Të dhënat për sasinë minimale të biokarburanteve, që do të përdoren në sektorin e transportit gjatë vitit pasardhës, publikohen në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.
4. Secila shoqëri e pajisur me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A”. për tregtimin me shumicë në treg duhet të marrë masa për të siguruar hedhjen në treg të sasisë minimale të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme vjetore të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Këto sasi duhet të certifikohen për plotësimin e kriterëve të qëndrueshmërisë, në përputhje me parashikimet e përcaktuara në nenet 9 e 11, të këtij ligji.
5. Strukturat e ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet përgjigjen për kontrollin e plotësimit të sasive minimale vjetore të biokarburanteve që duhet të vendosen në treg.
6. Shoqëritë e tregtimit me shumicë kanë të drejtë të tregtojnë sasi më të mëdha të biokarburanteve që tejkalon sasinë minimale të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, në përputhje me kërkesën e tregut.
7. Kur prodhimi vjetor vendas i biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, nuk mbulon të gjithë sasinë minimale vjetore, të përcaktuar nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, për t’u hedhur në treg, shoqëritë e tregtimit me shumicë, të pajisura me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A” për nënproduktet e naftës, detyrohen të garantojnë furnizimin e tregut me këtë sasi minimale vjetore nëpërmjet importit.
8. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet raporton pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për përmbushjen e objektivave kombëtarë të përdorimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme. Përgatitja e të dhënave për raportim do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Licenca e prodhimit dhe licenca e përzierjes

1. Personat juridikë të organizuar si njësi për prodhimin e biokarburanteve apo njësi për përzierjen e biokarburanteve, në përputhje me përcaktimin e pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, pajisen me “licencë prodhimi” dhe “licencë për përzierje”, për të ushtruar veprimtarinë e prodhimit dhe të përzierjes së biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në përputhje me kushtet e procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, duke përfshirë dhe shtimin e nënkategorive përkatëse në legjislacionin e licencimit.
2. Personat juridikë të pajisur me “licencë prodhimi” dhe rafineritë e naftës të pajisura me licencë koncesioni, sipas parashikimeve të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, kanë të drejtën dhe të përzierjes së biokarburanteve me nënproduktet e naftës, për transport.
3. Shoqëritë e pajisura me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse, me kodin VIII.1.A”, pajisen me “licencë përzierje” për të ushtruar veprimtarinë e përzierjes së biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në përputhje me kushtet e procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Licenca e prodhimit dhe ajo e përzierjes jepet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, përpara fillimit të punimeve për ndërtimin e impiantit të prodhimit/përzierjes së biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, sipas dispozitave të këtij ligji.
Licenca e prodhimit dhe licenca e përzierjes së biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, jepet për një afat 20 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
5. Shoqëritë e pajisura me “Licencë për përzierje” kanë të drejtë të kryejnë edhe veprimtarinë e tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, shoqëritë e tregtimit me shumicë të pajisura me licencë “Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse”, të shoqëritë e tregtimit me pakicë, të konsumatorët e mëdhenj dhe t’i eksportojnë ato.
6. Subjektet juridike që janë të pajisura me licencë prodhimi për impiantet e prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, dhe ata që zotërojnë licencën për përzierje, detyrohen të raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, për analizën e çmimit të prodhimit në fabrikë (*ex factory*) të këtyre produkteve.

Neni 14
Inspektorati shtetëror përgjegjës

1. Organi shtetëror i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së ushtruar nga personat juridikë, në përputhje me dispozitat këtij ligji, me përjashtim të strukturës përgjegjëse për verifikimin e kriterëve të qëndrueshmërisë, sipas neneve 10 e 11, të këtij ligji, është inspektorati shtetëror përgjegjës, në varësi të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.
2. Organizimi, funksionimi dhe përgjegjësitë e inspektoratit shtetëror përgjegjës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Inspektorati shtetëror përgjegjës shkëmben informacionin me strukturat doganore e tatimore, në momentin e prodhimit ose importimit, përpara hedhjes së produkteve në treg.

Neni 15
Regjimi fiskal

Trajtimi fiskal i prodhimit dhe tregtimit të biokarburanteve bëhet sipas legjislacionit doganor e tatimor në fuqi.

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16
Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen, si më poshtë vijon:
 - a) Shkeljet e pikës 3, të nenit 6, të këtij ligji, me 800 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;
 - b) Shkeljet e pikës 5, të nenit 6, të këtij ligji, me 1 000 000 lekë deri në 1 500 000 lekë;
 - c) Shkeljet e pikës 6, të nenit 6, të këtij ligji, me 100 000 lekë deri në 150 000 lekë;
 - ç) Shkeljet e pikave 2 dhe 4, të nenit 7, të këtij ligji, me 1 000 000 lekë deri në 1 500 000 lekë;
 - d) Shkeljet e pikave 2 e 4, të nenit 8, të këtij ligji, me 1 000 000 lekë deri në 1 500 000 lekë.
 - dh) Për shkelje të pikës 4, të nenit 12, të këtij ligji, me 50 për qind të vlerës së tregut të sasisë së produktit që mungon nga sasia minimale e

përcaktuar, por, në çdo rast, jo më pak se 5 000 000 lekë për çdo shkelje.

2. Kur veprimtaria ushtrohet pa licencat përkatëse, sipas dispozitave të këtij ligji, subjekti gjobitet me 4 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.
3. Masa e gjobës për shkeljet e parashikuara në pikat 1, shkronja “a”, “b”, “ç”, “d” e “dh”, dhe 2, të këtij neni, jepet nga inspektorati shtetëror përgjegjës, ndërsa për shkeljet e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, jepet nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet.

Në rast se ministria përgjegjëse për hidrokarburet dhe/ose inspektorati, përkatësisht sipas kompetencës së dhënies së gjobës, konstatojnë shkelje të dispozitave të këtij ligji mbi tri herë, procedojnë me bllokimin e zhvillimit të aktivitetit dhe njëkohësisht i propozojnë organit përgjegjës të licencimit për revokimin e licencës.
4. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, procesi i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen në përputhje me ligjin nr.10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.
5. Të ardhurat e përfituara nga gjobat derdhen në buxhetin e shtetit.

Neni 17 **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 5, 7, pikat 2, 4 dhe 5, 12, pikat 2 dhe 7, 13, pika 1, dhe 15, pika 2, të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për hidrokarburet që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të neneve 4, pika 2, 6, pika 7, 8, pika 4, dhe 12, pika 2, të këtij ligji.
3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për transportin që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 4, të këtij ligji.
4. Ngarkohet ministria përgjegjëse për mjedisin që, brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të pikës 3, të nenit 9, të këtij ligji.

5. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda periudhës tranzitore deri në vitin 2020, të nxjerrë aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse në zbatim të pikës 2, të nenit 10, të këtij ligji.

Neni 18

Dispozitë kalimtare

Njësitë e prodhimit dhe të përzierjes së biokarburanteve, të cilat operojnë aktualisht në treg, janë të detyruara që, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e akteve nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji, të plotësojnë kushtet përkatëse dhe të depozitojnë aplikimin pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, për të përfituar licencën e prodhimit dhe të përzierjes.

Neni 19

Shfuqizime

Ligji nr.9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, shfuqizohet.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI